

Konferenca e 4-t Ndërkombëtare e Bankës së Shqipërisë

Sarandë, 11-12 Shtator 2003

Koment mbi: “Nxitjen e eksporteve në Shqipëri”.

Sokol Qeraxhiu

Drejtor i Departamentit të
Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës
Banka e Shqipërisë

Të nderuar pjesëmarrës në konferencë,

Rritja e eksporteve duhet konsideruar si një pjesë e zhvillimit dhe e rritjes së përgjithshme ekonomike të Shqipërisë. Me disa përjashtime të karakterit të përkohshëm, eksportet nuk mund të rriten në një ambient të izoluar dhe në mënyrë të pavarur nga zhvillimi i përgjithshëm i ekonomisë dhe i infrastrukturës shqiptare. Megjithatë, rritja e eksporteve duhet konsideruar si një nga përparësitë e zhvillimit të ekonomisë shqiptare.

Duke patur parasysh këtë, referati i z. Çeku, mbuloi një gamë të gjerë çështjesh, të cilat nuk lidhen thjesht dhe drejtpërdrejt me nxitjen e eksporteve, por me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Referimi rikonfirmoi faktin që eksportet shqiptare janë të përqendruara në sektorë si turizmi, bujqësia, përpunimi i ushqimeve dhe minierat, dhe më pas renditi një numër faktorësh dhe masash që mund të merren për të nxitur dhe për të ndihmuar rritjen e eksporteve shqiptare.

Në mënyrë që të jetë më produktiv dhe i fokusuar në masat e rekomanduara, materiali identifikon disa fusha parësore, në të cilat duhet të orientohet zhvillimi dhe nxitja e eksporteve. Analiza kohore dhe sektoriale e paraqitur në të, synon të

identifikojë (rikonfirmojë) avantazhet krahasuese ekzistuese si edhe disa prej sektorëve primarë të ekonomisë. Siç u theksua, ky identifikim është bërë më tepër në mbështetje të sektorëve që janë në avantazh-bujqësia dhe turizmi, të cilët u diskutuan më parë.

Përfundimet e materialit theksojnë se Shqipëria duhet të adoptojë një sjellje strategjike dhe mbarëkombëtare për rritjen e eksporteve. Në përcaktimin e kësaj sjelljeje duhet që të përfshihen maksimalisht të gjithë aktorët e mundshëm, si të brendshëm ashtu dhe të jashtëm. Roli kryesor i përket Qeverisë Shqiptare. Duke ndjekur parimet e kësaj 'sjelljeje strategjike' nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës, qeveria duhet të hartojë strategji zhvillimi për fusha të ndryshme dhe, në të njëjtën kohë, të sigurojë koordinimin maksimal midis tyre.

Në komentet e mia, do të doja t'ju tërhiqja vëmendjen për disa çështje të cilat i konsideroj të rëndësishme, duke u përpjekur të anashkaloj ato, të cilat janë përmendur në referat.

Pse është e rëndësishme rritja e eksporteve?

Globalizimi dhe nevoja për integrim ekonomik.

Globalizimi ekonomik dhe synimi i Shqipërisë për të shkuar drejt integritit evropian janë faktorë, që çojnë në një treg më të hapur dhe në pakësimin apo në zhdukjen e pengesave. Marrëveshjet e tregtisë së lirë të nënshkruara kohët e fundit me shtete të rajonit, janë vetëm fillimi i procesit të integritit. Në këtë kontekst, importet dhe eksportet midis vendeve bëhen gjithnjë e më pak të kontrolluara nga qeveria dhe përgatisin terrenin për një nivel më të lartë konkurrence të lirë midis prodhuesve të mallrave dhe shërbimeve. Në mënyrë që t'i mbijetojnë këtij realiteti të afërt, prodhuesit shqiptarë duhet të jenë eficientë dhe të vlerësojnë e të përdorin në mënyrë të vazhdueshme avantazhet krahasuese të shtetit të tyre të origjinës.

Niveli i eksporteve është një tregues i zhvillimit ekonomik dhe i gatishmërisë për integrim.

Siç u përmend më lart, rritja e eksporteve duhet të mbështetet nga rritja e përgjithshme ekonomike. Më shumë eksporte do të realizohen si rezultat i hedhjes së produkteve më tërheqëse në tregun ndërkombëtar, si rezultat i prodhimeve dhe i shërbimeve të brendshme me cilësi dhe standarde më të larta si edhe si rezultat i një procesi prodhimi më eficient.

Për këtë arsye, niveli i eksporteve dhe ndryshimi i tij në kohë, mund të përdoret si një tregues i suksesit të reformave të brendshme ekonomike dhe i nivelit të "gatishmërisë" së prodhuesve shqiptarë të mallrave dhe shërbimeve, për të

konkurruar denjësisht në një treg ndërkombëtar. Gjatë procesit të integritit evropian, vendimmarrësit shqiptarë duhet ta përdorin këtë tregues me kujdes. Një tregues tjetër i rëndësishëm për ekonominë shqiptare mund të jetë ndryshimi në strukturën e eksporteve.

Probleme dhe arsye për nivelin e ulët aktual të eksporteve.

Disa nga vështirësitë dhe problemet e lidhura me eksportet shqiptare janë si vijon. Ato janë të renditura sipas rëndësisë që, unë personalisht, i vë secilës.

Mungesë e eksperiencës administruese.

Mungesa e eksperiencës dhe e njohurive administruese është e pranishme si në njësitë publike, ashtu edhe në ato private. Lëvizja e ekonomisë shqiptare nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu do të bëjë që ekonomia të jetë në një fazë tranzicioni deri sa ne të jemi tërësisht të familjarizuar me mekanizmin e zhvillimit të një ekonomie tregu.

Përsëri, në periudhën e globalizimit dhe të integritit, administrimi duhet të orientohet drejt të menduarit globalist. Ky duket si një ndryshim shumë i madh po të marrim parasysh 40 vitet e shkuara të eksperiencës shqiptare.

Gjatë 10 viteve të fundit, shumë ndryshime janë bërë në këtë drejtim. Megjithatë, shumë mbetet akoma për të bërë.

Pamjaftueshmëri kapitali dhe vështirësi në planifikim.

Biznesi në Shqipëri vazhdon të zhvillohet në bazë të investimeve të vogla me kapacitete të kufizuara prodhuese. Këto investime shpesh kanë karakter spontan, të paplanifikuar dhe ngrihen në bazë të bashkimit të kapitalit të një numri të vogël individësh.

Për këtë arsye është e vështirë të përqëndrohet një kapital i konsiderueshëm në një kompani të vetme. Numri i kompanive të orientuara nga teknologjia është shumë i kufizuar dhe në përgjithësi, sasia dhe cilësia e prodhimeve si edhe eficientia e prodhimit janë larg të qenit të krahasueshme me ato të rajonit.

Në anën tjetër, bizneset në Shqipëri nuk kanë një planifikim të qartë. Këto investime bëhen në mënyrë graduale dhe si kundërveprim i përgjigjeve të tregut. Faktori kryesor që ka kushtëzuar këtë mungesë vizioni, përveç kapitalit të kufizuar, është vështirësia në planifikim dhe mungesa e koordinimit të zhvillimit individual të biznesit me zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë shqiptare.

Probleme në strukturën e eksportit.

Mungesë e diversifikimit në eksporte.

Problemi më i dukshëm i eksporteve tona, siç është përmendur në mjaft publikime të Bankës së Shqipërisë, është mungesa e diversifikimit të shportës së eksporteve. Unë besoj se diversifikimi i vazhdueshëm i eksporteve, do të kishte, midis të tjerash, avantazhe direkte në qëndrueshmërinë e eksporteve dhe në rritjen e normës së punësimit.

Artikujt tekstilë dhe veshjet e këmbëve përfaqësojnë 50 për qind të eksporteve totale, ndërsa riekспортet përfaqësojnë 70 për qind. Ky nivel përqëndrimi i eksporteve do të ketë këto efekte negative:

- Luhatje në eksporte për shkak të lëvizjeve në çmimet ndërkombëtare të këtyre artikujve, të cilat, krahasuar me çmimet e artikujve të tjerë, janë përgjithësisht më të luhatshme.
- Tendanca e riekспортeve që mbështeten kryesisht në eksportin e fuqisë së lirë punëtore, është në përpjesëtim të zhdrejtë me zhvillimin ekonomik dhe me mirëqenien e vendit. Si të tilla ato nuk mund të konsiderohen afatgjata.

Parashikimet e Ministrisë së Ekonomisë (të cituara në referat) janë mjaft optimiste, pasi riekспортet parashikohen të zbresin deri në 54 për qind të eksporteve totale deri në vitin 2005. Megjithatë, unë besoj se kjo shifër, duhet parë më shumë si rezultat i reformave dhe i ndryshimeve në këtë fushë, se sa si një rënie në vëllimin dhe në peshën e riekспортëve.

Përmirësime dhe iniciativa.

Në fund do të doja të përmendja disa iniciativa dhe përmirësime të mundshme për nxitjen e eksporteve shqiptare.

Iniciativat kryesore në këtë drejtim duhet të vijnë nga Qeveria Shqiptare, e cila duhet që më shumë se të hartojë në mënyrë të izoluar, të koordinojë të gjithë faktorët vendas dhe të huaj në përcaktimin dhe në ndjekjen e një "strategjie kombëtare për nxitjen e eksporteve". Kjo gjë do të siguronte në mënyrë të veçantë transparencën dhe koordinimin maksimal të këtyre faktorëve.

Së fundi, do të doja të theksoja se është shumë i rëndësishëm, jo vetëm formulimi i kësaj strategjie, por edhe rivlerësimi i saj.

Ju falenderoj për vëmendjen!